



Australian Government

COVID-19 VACCINATION

Përgatitja për vaksinim kundër COVID-19

Përditësuar së fundi herë: 30 korrik 2021

Sigurohuni që të dhënat tuaja janë të sakta

Ndërsa ju prisni për takimin tuaj, ka disa gjëra që ju mund të bëni tani për t'u përgatitur.

Sigurohuni që të dhënat tuaja janë të [përditësuara në Medicare](#), nëse keni këtë të drejtë (dijeni se akoma mund të merrni vaksinën kundër COVID-19 nëse nuk keni të drejtë për Medicare. Ju mund ta bëni këtë duke përdorur:

- [Online llogarinë në Medicare](#) përmes [MyGov](#)
- [Aplikacionin Express Plus Medicare](#).
- Duke thirrur [programin Medicare](#).

Nëse nuk e keni konfiguruar llogarinë tuaj, ju mund të:

- [Regjistrohuni në Medicare](#), nëse tashmë nuk jeni regjistruar.
- [Rregulloni](#) online llogarinë tuaj Medicare, nëse jeni regjistruar në Medicare, por nuk keni lidhur Medicare me MyGov.
- [Merrni një Identifikues Individual të Shëndetit \(IHI\)](#), nëse nuk keni të drejtë për Medicare.

Pasi të keni marrur vaksinën tuaj, do të jeni në gjendje të merrni një deklaratë të historisë së imunizimit për të vërtetuar statusin tuaj të vaksinimit. Ju mund të gjeni [se si të merrni deklaratën tuaj të historisë së imunizimit](#) në faqen e internetit Services Australia.

Përgatitja për terminin tuaj

Ekziston një furnizim i kufizuar i vaksinave kundër COVID-19 në Australi dhe globalisht. Kjo do të thotë, njerëzit që kanë rrezik më të lartë nga COVID-19 dhe/ose ekspozimit ndaj virusit do të marrin vaksinën të parët. Njerëzit e tjerë do të marrin vaksinë në ndërkohë. Gjeni se kush do të jetë prioritet për vaksinim duke vizituar www.health.gov.au/covid19-vaccines. Mund të kontrolloni për të parë nëse mundeni të caktoni vaksinimin kundër COVID-19 duke vizituar <https://covid-vaccine.healthdirect.gov.au/>

Ju **nuk** duhet të merrni pjesë në një termin vaksinimi kundër COVID-19 nëse:

- jeni të sëmurë me ethe, kollë, hundë që rrjedhin ose simptoma të tjera që mund të jetë nga COVID-19
- jeni në pritje të rezultateve të testimit për COVID-19
- keni rezultuar pozitiv me COVID-19 dhe jeni në izolim

- jeni në karantinë
- jeni një kontakt i ngushtë i dikujt me COVID-19.

Nëse jeni në ndonjë nga kategoritë e mësipërme, kontrolloni me ofruesin tuaj të imunizimit. Ju mund të keni nevojë të riplanifikoni terminin tuaj për vaksinim. Vaksinat kundër COVID-19 nuk janë efektive në trajtimin e COVID-19.

Nëse keni pasur një vaksinë tjetër në 7 ditët e fundit para terminit të vaksinës kundër COVID-19, tregoni ofruesit tuaj të imunizimit. Ofruesi juaj i imunizimit mund t'ju kërkojë të riplanifikoj terminin tuaj.

Nuk ju kërkohet të testoheni për COVID-19 para vaksinimit nëse nuk keni ethe ose ndonjë simptomë të frymëmarrjes.

Planifikoni prej më parë për dy doza

Është e rëndësishme që ju të merrni dy doza të vaksinës kundër COVID-19. Duhet të paktën tre javë dy dozat të jenë larg njëra tjetrës nëse merrni vaksinën COVID-19 Pfizer [Comirnaty]. Duhet të ketë diku 12 javë në mes dy dozave nëse merrni vaksinën AstraZeneca kundër COVID-19. Shkurtimi i intervalit nga 12 javë në më pak se 4 javë në mes dozave mund të jetë e përshtatshme në rrethana të caktuara. Mbrojtja optimale kundër COVID-19 nuk do të ndodhë deri të paktën një deri dy javë pas dozës suaj të dytë.

Çfarë duhet të pritni në terminin tuaj të vaksinimit

Ju duhet të sillni këto në terminin tuaj të vaksinimit kundër COVID-19:

- foto të ID-së, nëse keni një të tillë
- Kartë Medicare, në qoftë se ju keni një të tillë
- ID-në e punonjësit, nëse merrni vaksinë kundër COVID-19 për shkak të profesionit tuaj.
- informacione në lidhje me ndonjë nga gjendjet tuaja mjekësore, alergjitë, çrregullimet e gjakderdhjes ose imunokompromisin (p.sh. sistemi imunitar i dobësuar)
- informacione në lidhje me ndonjë ilaç që merrni
- informacione për çdo vaksinë të marrë të mëparshme kundër COVID-19 (brendi i vaksinës dhe data e vaksinimit)
- informacione në lidhje me çdo reaksion që keni pasur ndaj ndonjë vaksine në të kaluarën
- emri i GP-së (mjekut personal)/ të tanishëm dhe ndonjë mjeku specialist që takoni
- një maskë fytyre (nëse kërkohet nga shteti/territori juaj).

Në terminin tuaj, ju do të jeni në gjendje të diskutoni çdo pyetje që keni në lidhje me vaksinimin kundër COVID-19 me ofruesin tuaj të imunizimit.

Tregoni ofruesit tuaj të imunizimit nëse jeni nën moshën 60 vjeçe, dhe nëse keni ndonjë gjendje mjekësore ose nëse jeni duke marrë medikamente. Në veçanti sigurohuni që t'u tregoni atyre nëse:

- keni pasur reaksion alergjik nga doza e mëparshme e vaksinës kundër COVID-19 ose të ndonjë përbërësi të vaksinës
- keni pasur anafilaksi (një lloj reaksioni të rëndë alergjik) ndaj vaksinave ose medikamenteve tjerë
- reaksion tjetër serioz që sipas kontrollit të ekspertit i është atribuar dozës së mëparshme të vaksinës kundër COVID-19
- keni të kaluar të mastocitozës së konfirmuar me anafilaksi të përsëritur që kërkon trajtim
- keni qenë të diagnostifikuar me sindromën e rrjedhjes së kapilarit
- keni pasur trombozë venoze dhe/apo arteriale në kombinim me trombocitopeni, përfshirë sindromën trombotike trombocitopenike (TTS), pas dozës së mëparshme të vaksinës kundër COVID-19

- keni të kaluar me trombocitopeni të shkaktuar nga heparina (HIT), trombozë centrale venoze sinusale (CVST), mpiksje të gjakut në venat abdominale (venat splankike) apo sindromën antifosfolipid të asocuar me mpiksjen e gjakut
- keni pasur miokardi dhe/ose perikardi
- momentalisht keni apo keni pasur ethe akute reumatike apo endokardi
- keni sëmundje kongjenitale të zemrës
- keni kardiomiopati të zgjeruar (për njerëzit e moshës nën 30 vjeç)
- keni zemër të dëmtuar rëndë
- jeni pranues i transplantimit të zemrës
- keni një çrregullim gjakderdhjeje ose po merrni terapi antikuagulante (hollim gjaku)
- jeni shtatzënë
- jeni të imonukompromituar (dmth. kanë një sistem imunitar të dobësuar ose merrni ilaçe për imunizim)
- keni pasur COVID-19 në të kaluarën, ose momentalisht keni COVID-19
- keni marrë një vaksinë tjetër kundër COVID-19 (dhe cili brend)
- keni marrë ndonjë vaksinë në 7 ditët e fundit

Në disa rrethana, mund të jetë më mirë të keni një diskutim me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor rreth vaksinimit para se të bëni një termin për vaksinim. Ju gjithashtu mund të lexoni informacionet mbi vaksinën për merrni:

- [informacione për vaksinën Pfizer \(Comirnaty\) kundër COVID-19](#), ose
- [informacione për vaksinën AstraZeneca kundër COVID-19](#)

Si do ta merrni vaksinën

Ju do të merrni vaksinën si një injeksion, më së shpeshti në muskujt e sipërm të krahut. Ju duhet të qëndroni në klinikën e vaksinimit për vëzhgim për të paktën 15 minuta pas vaksinimit. Në varësi të historisë suaj mjekësore, mund t'ju kërkohet të prisni në klinikë për 30 minuta.

Si përdoren informacionet që jepni në terminin tuaj?

Për informacione mbi mënyrën se si të dhënat tuaja personale janë mbledhur, ruajtur dhe përdorur vizitoni <https://www.health.gov.au/using-our-websites/privacy/privacy-notice-for-covid-19-vaccinations>